

KONTRATË SHITBLERJE

(KUOTASH)

Sot më datë 18/01/2024 mes palëve të mëposhtme kontraktuese lidhet kjo kontratë shitblerje kuotash:

Shitësi: **Znj. Ersida Hako**, atësia Viktor, shtetas shqiptar, lindur më 21.10.1987 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Nr. Personal I76021042P (referuar me poshtë si **Shitësi**).

Blerësit: **Ehsen Këllici**, atësia Petrit, shtetas shqiptar, lindur më 07.07.1978 lindur në Tiranë dhe banues në rr: "Haxhi Dalliu", Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr. Personal H80707059R.

(referuar më poshtë si **Blerësit**)

Dispozita të përgjithshme

- A. Shoqëria "SOLE" shpk, është person juridik, i regjistruar në Regjistrin Tregtar të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me Nr. NUIS M02115021B. Kapitali i shoqërisë "SOLE" shpk është 100,000.00 (njqind mije) Lekë, i perbere nga 1 (nje) kuot.
- B. Shitësi është ortak i vetem i Shoqërisë "SOLE" shpk dhe zotëron 100 % (njqind përqind) të kuotave, dhe dëshiron t'ia shesë bleresit, kuotat e tij.
- C. Blerësit Z. Ehsen Kellic, dëshiron të blejë nga shitësi, kuotën me vlerën totale prej 100 % (njqind përqind), e cila do t'i blihet shitësit në mënyrën që do të përcaktohet më poshtë.

Në përputhje me nenin 73: "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave" pika 1/b dhe pika 3 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare», i ndryshuar, neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, si dhe në Statutin të Shoqërisë "SOLE" sh.p.k, Palët bien dakord sa më poshtë:

Neni 1 Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotës së Kapitalit të Shoqërisë prej 100% (njqind përqind) që zotëron Shitësi në kapitalin themeltar të Shoqërisë ("Kuota"), totalisht në masën prej 100 % (njqind përqind) Z. Ehsen Këllici.
Kjo kuotë transferohet nga Shitësi në pronësi të Blerësit, sipas mënyrës së përcaktuar më sipër.

- 1.2 Blerësi e pranon pronësinë e 1 (një) kuote, pjesë e totalit prej 100% (njqind përqind) të Kapitalit të Shoqërisë të përbere si më sipër.

Neni 2

Çmimi i Shitjes

- 2.1 Çmimi për blerjen e kuotës do të jetë në total i barabartë me 100,000 (njqind mije) lekë.
- 2.2 Palët deklarojnë se çmimi i shitjes është likujduar në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 2.3 Titulli i pronësisë mbi Kuotat do të transferohet nga Shitësi tek Blerësi në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 2.4 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi fiton të drejten e pronësisë mbi Kuotën përkatëse, ndërsa Shitësi zhvishet nga cdo e drejtë pronësie mbi Kuotën dhe të drejtat që rrjedhin prej saj.
- 2.5 Me nënshkrimin e kësaj kontrate blerësi autorizohet të kryejë procedurat e regjistrimit të këtij veprimi juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 3

Garancitë

- 3.1 Shitësi është pronar i ligjshëm i 100 % (njqind përqind) të kuotave në shoqërinë "SOLE" sh.p.k, të cilat në total kalojnë në pronësi të blerësit.
- 3.2 Shitësi garanton Blerësin që 100 % (njqind përqind) e kuotave të transferuara në total, janë krejtësisht të lira dhe nuk janë vendosur si mjet ligjor për të siguruar ekzekutimin e ndonjë detyrimi.
- 3.3 Palët deklarojnë dhe garantojnë se duke lidhur dhe zbatuar këtë Kontrate nuk vijnë në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore, kontraktuale apo statutore, kur është e zbatueshme.
- 3.4 Palët deklarojnë se pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe kalimit të pronësisë nga shitësi tek blerësi, shitësi clirohet nga cdo detyrim i mëparshëm, aktual dhe i ardhshëm ndaj shoqërisë "SOLE" shpk dhe palëve të treta.

Neni 4

Regjistrimi


- 4.1 Regjistrimi i transferimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) kryhet në bazë të nenit 74 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 « Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » si dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
- 4.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate shitje shoqëria "SOLE" shpk do të ketë një ortak dhe konkretisht:

Z. Ehsen Këlliçi zotërues i një kuote që përfaqëson 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Neni 5

Ligji i zbatueshëm

- 5.1. Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë",



Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe Statuti i Shoqërisë “SOLE” sh.p.k.

Neni 6
Juridiksioni

- 6.1. Për çdo mosmarrëveshje lindur mes Palëve lidhur me interpretimin, zbatimin e kontratës e cila nuk arrihet të zgjidhet me mirëkuptim mes tyre, juridiksioni kompetent do të jetë ai i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Neni 7
Dispozita të fundit

- 7.1 Nenet e përgjithshme janë pjesë e pandarë e kësaj kontrate.
7.2 Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët.
7.3 Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me pëlqimin e të dyja palëve, duke respektuar formën shkresore.

Kjo kontrate u përpilua në 3 (tre) kopje me vlerë të barabartë ligjore.. Palët deklarojnë se njohin dhe kuptojnë të gjithë përmbajtjen e kësaj kontrate. Kontrata u pranua nga palët dhe u gjend sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të shprehur. Ajo u nënshkrua në mënyrë të rregullt, nga palët.

SHITËSI
ERSIDA HAKO

Ersida Hako



BLERËSIT
EHSEN KËLLIÇI

Ehsen Kelliçi

